

VENDIM
Nr. 859, datë 7.12.2016

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT “STANDARDET SHTETËRORE PËR
SPECIFIKIMET TEKNIKE TË INFORMACIONIT GJEOPHAPËSINOR NË SHQIPËRI -
TEMA: SISTEMI
I ADRESAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 2, shkronja “dh”, e 16, pika 1, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri – Tema: Sistemi i adresave”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autoritetet përgjegjëse për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinoe për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**STANDARDET SHTETËRORE PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË INFORMACIONIT
GJEOPHAPËSINOR NË SHQIPËRI - TEMA: SISTEMI I ADRESAVE**

1. PËRSHKRIM MBI STANDARDIN

Ky dokument përmban standardet e specifikimeve teknike të të dhënave gjeohapësinore për ndërtimin e NSDI, duke u mbështetur në Direktivën INSPIRE. Autori i këtij produkti është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC). Data e publikimit të versionit Nr.1 është Qershor 2016. Emërtimi i dokumentit është: ASIG_Standard_NSDI_2016_SA_v.1 ku:

ASIG – Autoriteti përgjegjës për krijimin e standardit

Standard – Lloji i dokumentit

NSDI – Qëllimi i dokumentit

2016 – Viti i krijimit

SA– Tema për të cilën është krijuar standardi, Sistemi i Adresave

v.1 – Numri i versionit të standardit

2. HYRJE

2.1. SI LEXOHEK DOKUMENTI

Ky material është i strukturuar në katër kapituj kryesorë:

- 1- **Përshkrim mbi standardet** – Në këtë pjesë jepet emërtimi dhe autori i standardeve.
- 2- **Hyrje** – Në këtë pjesë jepen përshkrime dhe shpjegime për të kuptuar mënyrën si organizohet i gjithë informacioni dhe si mund të kuptohet më lehtë.
- 3- **Tema** – Në këtë pjesë jepen specifikimet teknike për secilën temë.
- 4- **Aneke** – Në këtë pjesë jepen informacione shtesë, shpjeguese, në ndihmë të lexuesve.

Përmbajtja e Kapitullit 3 është strukturuar në 6 pjesë kryesore:

- 1- **Përshkrimi i temës** – Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e temës.
- 2- **Diagramat UML** – Këtu jepet Përmbajtja e Katalogut të Tipologjive përkthyer sipas gjuhës UML.
- 3- **Katalogu i Tipologjive** – Këtu shpjegohet struktura e temës me të gjithë elementët e saj përbërës.
- 4- **Metadata** – Këtu jepet referenca për specifikimet teknike për metadata-t e temës përkatëse.
- 5- **Sistemi Koordinativ Reference** – Këtu pëcaktohet Sistemi Koordinativ i Referimit që është miratuar sipas vendimit Nr. 669 datë 7/8/2013 i ndryshuar me vendim Nr. 322, datë 27.4.2016.
- 6- **Cilësia e të dhënave** – Këtu jepet një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementëve dhe matjes së tyre.

Diagramat UML ofrojnë një mënyrë të shpejtë për të parë elementët kryesorë të specifikimeve dhe marrëdhëniet mes tyre. Përkufizimi mbi llojin e objektit, gjeohapësinor, atributet dhe marrëdhëniet janë të përfshira në Katalogun e Tipologjive (Feature Catalogue). Personat të cilët kanë ekspertizë tematike por nuk janë të familjarizuar me UML-në mund ta kuptojnë plotësisht përmbajtjen e modelit të të dhënave duke u fokusuar tek Katalogu i Tipologjive. Për përdoruesit, Katalogu i Tipologjive mund të jetë veçanërisht i dobishëm për të kontrolluar nëse ai përmban të dhënat e nevojshme për aplikacionet që ata përdorin.

Në tabelat e mëposhtme jepet një shpjegim mbi përmbajtjen dhe mënyrën e organizimit të informacionit në tabelat e të dhënave në Katalogun e Tipologjive.

Tabela Nr.1, 2, me anë të një shablloni, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e tipologjive dhe të attributeve të tyre.

Tabela Nr.3, me anë të një shablloni, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e kodlistës.

Tabela 1

Emri - Emërtimi i tipologjisë	
Përkufizimi:	Përkufizimi sipas direktives INSPIRE për tipologjinë.
Përshkrimi:	Shënime dhe përshkrime të tjera për tipologjinë.
Tipi i tipologjisë	Tipi i elementit i cili mund të jetë i këtyre llojeve: «featureType» - një element i cili mund të jetë real në terren apo një fenomen abstrakt «dataType» - një element tabelor i cili shërben vetëm si tabelë attributesh për tu lidhur me një element tjetër. «enumeration» «codeList» - listë e parapërgatitur vlerash ku elementi duhet të marrë vlerë. Enumeration nënkupton "renditje vlerash", ndërsa codeList nënkupton "listë vlerash ose ndryshe kodlistë". Në dokument gjenden të shqipëruara si "Numërtimet dhe kod listat". «Imported» - të dhëna të specifikuara në tema të tjera të direktivës INSPIRE. Në dokument gjenden "Të dhënat e Importuara"
Gjeometria	Gjeometria e elementit sipas formatit vektor mund të gjendet në tre forma: pikë, linjë ose polygon. Abstrakt – kur elementi nuk është element real në terren por konsiderohet vetëm si fenomen.
Shumëllojshmëria:	Lloji dhe numri i vlerave që mund të marrë atributi: 0..* - mund të marrë shumë lloje vlerash ose asnjë vlerë 1..* - mund të marrë minimum 1 vlerë ose shumë vlera 0..1 - mund të mos marrë asnjë vlerë ose nëse merr vlerë, duhet të marrë vetëm 1 vlerë të vetme. 1 - duhet të marrë detyrimisht 1 vlerë
Detyrueshme	Po – nëse atributi është i detyrueshëm të plotësohet Jo – nëse atributi nuk është i detyrueshëm të plotësohet
Lidhjet	Në tabelën e lidhjeve "LIDHJET" tregohen marrëdhëniet hierarkike ndërmjet elementëve të ndryshëm në këtë temë po ashtu dhe në temat e tjera. Këto marrëdhënie pasqyrojnë lidhjet që realizohen në skemat UML.

Tabela 2

ATRIBUTET
-- Emri -- Emërtimi i atributit. -- Përkufizimi -- Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE të elementëve. -- Përshkrimi -- Shënime dhe përshkrime të tjera për elementin. [Detyrueshme : Detyrueshmëria nëse atributi duhet të marrë vlerë p.sh: PO]

Tabela 3

ATRIBUTET
💡 Vlera e parë e listës së gatshme p.sh: <i>Ligjor</i> -- Emri -- Emërtimi i vlerës. -- Përkufizimi -- Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE të elementëve.
💡 Vlera e dytë (etj) e listës së gatshme p.sh: <i>Jo Ligjor</i> -- Emri -- Emërtimi i vlerës. -- Përkufizimi -- Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE të elementëve.

2.1.1. KARAKTERISTIKAT E <<VOIDABLE>> DHE SHUMËLLOJSHMËRIA.

Stereotipi <<voidable>> përdoret për të përshkruar ato përkatësi të objekteve gjeohapësinore të cilat mund të jenë ose mund të mos jenë prezente në grupet e të dhënave gjeohapësinore, edhe pse ato mund të ekzistojnë në botën reale. Kjo nuk do të thotë që këtyre përkatësive duhet ti jepet një vlerë.

Për të gjitha përkatësitë e përcaktuara për objektet gjeohapësinore duhet të paraqitet një vlerë – ose vlera përkatëse (nëse është e disponueshme në grupin e të dhënave që mirëmbahet nga ofruesi i të dhënave) ose vlera ‘void’. Një vlerë void nënkupton që nuk ekziston një vlerë përkatëse në grupet e të dhënave gjeohapësinore që mirëmbahen nga ofruesi i të dhënave ose që asnjë vlerë përkatëse nuk mund të nxirret nga vlerat ekzistuese.

Arsyeja e përdorjes së vlerës void duhet të paraqitet kurdo të jetë e mundur duke përdorur një nga vlerat e listuara në kod listen VleraArsyesSëPavlefshmërisë (VoidReasonValue).

Stereotipi <<voidable>> nuk jep informacion nëse karakteristika ekziston ose jo në botën reale. Kjo shprehet duke përdorur shumëllojshmërinë:

Nëse një karakteristikë mund të ekzistojë apo mund të mos ekzistojë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 0. Psh nëse një adresë ka apo nuk ka një numër shtëpie, shumëllojshmëria e përkatësisë përkatëse do të jetë 0..1.

Nëse për një karakteristikë të caktuar ekziston të paktën një vlerë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 1. Psh nëse një njësi administrative ka gjithmonë të paktën një emër, shumëllojshmëria e përkatësisë përkatëse do të jetë 1..*.

2.1.2. NUMËRTIMET DHE KOD LISTAT (ENUMERATION AND CODELIST).

Kod listat modelohen si klasa në skemat e aplikimit por vlerat e tyre menaxhohen jashtë skemave të aplikimit. Në kod listë, ‘vlera të tjera’ përcakton llojin e përmbajtjes së kod listës përcaktuar specifikisht si më poshtë:

‘jo’ përfaqëson kod lista që përmbajnë vetëm vlera të specifikuara në këtë rregullore.

‘të kufizuara’ përfaqëson kod lista të përmbajnë vlera të specifikuara në këtë rregullore dhe vlera të tjera të limituara të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

‘të hapura’ përfaqëson kod lista që përmbajnë vlera të specifikuara në këtë rregullore dhe vlera shtesë në cdo nivel, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

‘po’ përfaqëson kod lista që përmbajnë vlera të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

Vlerat shtesë të përcaktuara nga ofruesit e të dhënave nuk duhet të zëvendësojnë apo modifikojnë vlerat ekzistuese të përcaktuara në rregullore.

Në rastin kur ofruesit e të dhënave do të përdorin kod lista me vlera jo të përmbajtura në rregullore, ofruesit janë të detyruar ti bëjnë këto vlera bashkë me përkufizimet e tyre, të disponueshme në një regjistër. Kjo do të mundësojë që dhe përdoruesit e tjerë ti kuptojnë këto vlera dhe të kenë mundësi ti përdorin.

2.1.3. PARAQITJA E ASPEKTIT KOHOR.

Skemat e aplikimit përdorin atributin “FillimiCiklitJetësor” dhe “PërfundimiCiklitJetësor” për të regjistruar jetëgjatësinë e një objekti gjeohapësinor.

Atributi “FillimiCiklitJetësor” specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është futur apo ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinores (në sistem). Atributi “PërfundimiCiklitJetësor” specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është zëvendësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënave gjeohapësinores (në sistem). Këto vlera kohore nuk kanë të bëjnë me karakteristikat kohore të objektit në botën reale.

Ndryshimet që bëhen në atributin “PërfundimiCiklitJetësor” nuk shkaktojnë ndryshime në atributin “FillimiCiklitJetësor”.

❖ Shënim i rëndësishëm:

Disa terma në katalogun e tipologjive si p.sh: tipi i tipologjisë, etj, nuk janë përkthyer qëllimisht në gjuhën Shqipe. Qëllimi parësor është që të mos humbasë kuptimin gjatë përkthimit dhe së dyti të përdorë një gjuhë unike sipas termave të Direktivës INSPIRE.

2.2. DETYRIMET LIGJORE

Në bazë të ligjit Nr 72/2012, neni 16, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, ASIG është përgjegjës për krijimin e standardeve për secilën nga temat e përcaktuara në ligj (neni 11), në përputhje me standardet europiane (direktiva INSPIRE).

Standardet teknike të të dhënave gjeohapësinore për krijimin e NSDI në Shqipëri, janë përshtatur nga specifikimet teknike të temave përkatëse në direktivën INSPIRE. Për implementimin e direktivës, kërkohet që të gjithë aktorët të implementojnë disa standarde të përbashkëta, të cilat mundësojnë ndërveprimin e shërbimeve dhe harmonizimin e të dhënave.

Standardet (Rregullat e Implementimit (IR)) duhet të krijohen për fushat e mëposhtme:

- **Metadata** – në këtë fushë direktiva përcakton standardet sesi metadata-t duhen të jenë. Ky standard është unik dhe i aplikueshëm për të gjithë institucionet ose palët e treta (siç është e përcaktuar në fushën e veprimit të kësaj direktive), të cilët do implementojnë këtë direktivë.
- **Specifikimi i të dhënave** – standardet e kësaj kategorie përfshijnë të gjitha atributet e objekteve të ndryshme të cilat do të publikohen. INSPIRE ka përcaktuar disa attribute si bazë të cilat do të shërbejnë për publikimin e të dhënave të ndryshme. Vendet e ndryshme, në varësi të ligjeve ose nevojave të brendshme mund të shtojnë attribute të tjera, për ti bërë sa më të përdorshme të dhënat. Të gjitha të dhënat që do të shtohen duhet të jenë të dokumentuara dhe të aprovuara nga institucionet përgjegjëse lokale.

2.3. FUSHA E VEPRIMIT

Të gjithë autoritetet publike, kompani private apo individët, të cilët mbajnë ose përpunojnë të dhëna gjeohapësinore për llogari të Institucioneve Publike, janë të detyruar ti nënshtrohen kësaj rregulloreje.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga direktiva INSPIRE ka proceset dhe ciklin jetësor si më poshtë:




Figura 1

Planifikimi – Është procesi gjatë të cilit krijohen strukturat e të dhënave të nevojshme për të publikuar informacionin në portal. Rezultatet e këtij procesi janë modelet e ndryshme të të dhënave.

Vlerësimi – Është procesi gjatë të cilit të dhënat ekzistuese testohen kundrejt modelit. Rezultati i këtij procesi do jetë çertifikimi i të dhënave ose nevoja për të modifikuar të dhënat për tu përshtatur me modelet e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit.

Procesimi – Është procesi gjatë të cilit mbledhen dhe manipulohen atributet e të dhënave për të prodhuar informacion kuptimplotë. Manipulimi i tyre bëhet kundrejt modeleve të përcaktuar gjatë planifikimit. Rezultatet e këtij procesi, janë bashkësi të dhënash të cilat janë gati për tu publikuar.

Shpërndarja – Është procesi gjatë të cilit të dhënat vihen në dispozicion për përdoruesit (Qytetarët, Autoritetet Publike, Organizatat ose Palët e treta). Përdoruesi mund të shkarkojë, përdorë, analizojë ose të citojë ato. Publikimi i të dhënave bazohet në modelet e ndryshme të përdorimit.

Zbulimi – Është proces i vazhdueshëm mbi të dhënat e publikuara, gjatë të cilit zbulohen të dhëna të reja ose të dhëna jo cilësore.

Analiza – Është procesi i analizimit të të dhënave të evidentuara në fazën e zbulimit. Gjatë këtij procesi merret vendimi çfarë do bëhet më të dhënat që janë evidentuar.

Përditësimi – Është procesi kur propozohet shtimi, modifikimi ose fshirja e të dhënave. Ky proces rregjistrohet nga procesi i analizimit të të dhënave ekzistuese dhe të publikuara.

Arkivimi – Është procesi gjatë të cilit, bashkësitë e të dhënave që nuk nevojiten të aksesohen, arkivohen duke u bazuar në standarde lokale dhe legjislationin në fuqi të vendeve ku implementohet. Rezultati i këtij procesi janë të dhënat të cilat bëhen të pa aksesueshme për publikun, me akses vetëm nga autoritetet specifike. Këto të dhëna vazhdojnë të ruhen për arsye të përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi ose standartet specifike.

Shkatërimi – Është procesi gjatë të cilit, të dhënat bëhen të pa rikuperueshme. Ky proces bazohet në standarde lokale ose legjislatione në fuqi.

3. TEMA

3.1. SISTEMI I ADRESAVE

3.1.1. PËRSHKRIMI I TEMËS

Përkufizim:

Një adresë është identifikim në mënyrë të saktë dhe unik i vendndodhjes së caktuar të një prone, ndërtese, apartamenti apo trualli të lirë në shkallë vendi bazuar në identifikimin e adresës.

Përshkrim:

“Adresa” përbëhet nga fjalë, numra dhe shenja ortografike, të renditura sipas një rregulli të caktuar, të cilat tregojnë vendndodhjen e saktë dhe unike të një ndërtese, apartamenti ose të një trualli të lirë. Ajo formohet nga shkronja të alfabetit shqip, latin dhe numra arabë.

Adresat shërbejnë për disa qëllime të përgjithshme, këto përfshijnë:


- Vendndodhje (p.sh. për vizitat apo dorëzimin e postës);
- Identifikim (p.sh. në kontekstin e regjistrimit të një ndërtese);
- Juridiksion (p.sh. autoriteti përgjegjës për të identifikuar pronën nga adresa);
- Ndarjet dhe renditjet;
- Përgjigje emergjente.

Disa lloje objektesh mund të jetë i lidhur me pronën. Lloji më i përhapur i adresave të objekteve janë ato të lidhura me parcelat e tokës dhe ndërtesat (përfshirë banesa apo apartamente). Në disa vende, objekte të llojeve të tjera kanë një adresë, të tilla si mobileritë, stacionet e pompimit të ujit, vende ankorimi, parkingje dhe hambare bujqësore etj. Edhe pse ata nuk marrin kod postar mund të kenë nevojë të kenë një adresë për funksione të tjera. Kjo është e njëjtë si në zonat rurale dhe urbane.

Vendndodhja e një adrese është përcaktuar më shpesh në një mënyrë që ajo të identifikojë vendndodhjen lidhur me objekte të adresueshme.

Edhe pse të gjitha sistemet e adresave kombëtare ose lokale ndajnë koncepte të ngjashme dhe cilësi të përgjithshme, dallimet ekzistojnë në standardet formale dhe joformale, rregullat, skemat dhe modelet e të dhënave brenda Europës.

Për të ilustruar dallimet le të marrim një shembull, apartamentet majtas në katin e parë të hyrjes 6 të ndërtesës 360 në MainStreet:



Edhe në kuadër të shteteve anëtare ka disa mundësi si do të duket adresa e banesës, si një shembull. Në tabelën në vijim janë dhënë disa shembuj:

Suedi	Danimarkë	Britani e Madhe
Mainstreet 6 1101 12345 Farsta	Mainstreet 6 1 TV 2400 København NV	Kati 1A 6, Mainstreet Fairfield Wandsworth London SW18 1ED
Hollandë	Belgjikë	Gjermani
Mainstreet 24 2500 AA Den Haag	Mainstreet 6 bus 3 2140 Antwerpen	Mainstreet 6 67 433 Kelkheim
Spanjë	Republika Çeke	
Mainstreet 6 left 1 1 Cortijo del Marqués 41037, Écija (Sevilla)	Mainstreet 360/6 Chodov 149 00 Prague 41	

SHËNIM: Sistemet e adresave në shumë shtete anëtare kanë të zhvilluar më mirë rregullat për zonat rurale. Në INSPIRE specifikimi i të dhënave duhet të sigurojë një strukturë të përgjithshme, kështu që bëhet e mundur për të shkëmbyer këto adresa. Koncepti i përgjithshëm i adresave, një përshkrim hierarkik të një

rruge nga emri i shtetit, përmes bashkisë, nga rruga për të ndërtesa dhe banesa është e përfaqësuar në komponentët e ndryshëm të adresave.

Në projektimin e skemës së aplikimit për shkëmbimin e adresave brenda Europës është përdorur struktura e përgjithshme e cila mund të gjendet në çdo shtet anëtar. Kjo përbëhet nga elementet e mëposhtëm:

- Emri i njësisë administrative (për shembull emri i Bashkisë)
- Emri i adresës së zonës (për shembull emri i qytetit)
- Emri i rrugëkalimit (për shembull emri i rrugës)
- Emri i vendndodhjes së adresës (për shembull, numri i shtëpisë)
- Kodi postar (për shembull kodi postar), i cili fillimisht përdorej për qëllime të dërgesës postare, por tani përdoret për aplikim më të gjerë.

Kombinimi i (disa prej) këtyre komponentëve krijojnë (bëjnë) një adresë.

3.1.2. TERMAT DHE PERKUFIZIMET

1) Objekt i adresueshëm (Addressable object)

Lloji i objektit gjeohapësinor mund të ketë raste, për të cilat është domethënëse të lidhësh adresat në kontekstin e qëllimit të INSPIRE.

Shënim: objektet më të zakonshme të adresueshme janë pronat, parcelat kadastrale, ndërtesat, hyrjet e ndërtesave, banesat, apartamentet, godinat në bashkëpronësi, etj. Objekte të adresueshme gjithashtu mund të kërkon lloje të tjera të vendeve apo të ndërtimeve si vende ankorimi, pika interesi, fusha sportive, parqe, terminale trafiku, ndërtime teknike, pika ofrimi të shërbimeve, p.sh. shërbime postare, etj.

2) Pronë (Property)

Parcela të tokës dhe / ose objekte fikse bashkangjitur saj.

SHËNIM1: mund të përfshijnë, por nuk është i kufizuar në pasuri të patundshme.

SHËNIM2: nuk mund të jetë e kufizuar në vetëm në një marrëdhënie me parcelën kadastrale.

3) Adresa postare (Postal address)

Set detajesh të cilat, për një artikull postar, mundëson përcaktimin e qartë të një pikë dorëzimi aktuale apo potenciale, zakonisht kombinuar me specifikimin e të adresuarit dhe/ose email _i.

SHËNIM për përshkrimin e pikave të dërgesës postare më së shumti përdoren komponentët e përbashkëta të adresave si p.sh emri i rrugëkalimit dhe vendosja (numri adresës, etj), përveç këtyre mund të përfshijnë dhe emërtimet postare të përcaktuara si: kodi postar dhe identifikuesi kutisë postare.

Edhe pse këto emërtime postare ishin menduar fillimisht vetëm për përdorimin e shërbimit postar veçanërisht (kodi postar), shpesh janë miratuar dhe përdoren për qëllime të tjera, si një identifikues gjenerik.

3.1.3. DIAGRAMAT UML

3.1.3.1. SKEMA E APLIKIMIT TË 'SISTEMI I ADRESAVE'




Figura 1 - Lidhja e Skemës së aplikimit të 'Sistemit të Adresave' me temat e tjera.

3.1.3.2. NUMËRTIMET DHE KOD LISTAT




Figura 3 – Numërtimet dhe kodlistat.

3.1.3.3. TIPOLOGIA E TEMES "SISTEMI I ADRESAVE"




Figura 4- Feature type – Tipologija e temës 'Sistemi i Adresave'

3.1.3.4. IMPORTED TYPES




Figura 5 - Lidhja e Sistemit të Adresave me Parcelat Kadastrale, Emërtimet Gjeografike dhe Njesitë Administrative.




Figura 6 – Të dhënat e Importuara nga temat e tjera.

1






Figura 8- Tipologjia e temës 'Sistemi i Adresave'

3.1.4. KATALOGU I TIPOLOGJISË – FEATURE CATALOGUE

3.1.4.1. PËRSHKRIM

“Adresa” përbëhet nga fjalë, numra dhe shenja ortografike, të rënditura sipas një rregulli të caktuar, të cilat tregojnë vendndodhjen e saktë dhe unike të një ndërtese, apartamenti ose të një trualli të lirë. Ajo formohet nga shkronja të alfabetit shqip, latin dhe numra arabë.

Adresa shërben për të identifikuar në mënyrë të saktë dhe unike vendndodhjen e çdo ndërtese, apartamenti apo trualli të lirë në shkallë vendi, dhe jep informacion të strukturuar për emrin e njësisë së qeverisjes vendore / administrative / qytetin ose fshatin / rrugën / ndërtesën / numrin e hyrjes / apartamentin / kodin postar.

Për të bërë **numërtimin e ndërtesave** të një bulevardi, rruge, rrugice, sheshi ose parku më parë caktohet vendndodhja e ndërtesave dhe kufijtë e tyre.

Pra, duhet të përcaktohen cilat ndërtesa kanë dalje në një rrugë dhe mund të marrin adresën e kësaj rruge. Në hartën e NJQV¹ përcaktohen kufijnjtë, nga të cilat ndërtesat do të jenë pjesë e rrugës që do të shërbejë si element i adresës së tyre.

Ndërtesat e çdo rruge, bulevardi, autostrade, rrugice, sheshi ose parku, që kanë një emër të caktuar, duhet të kenë një numër rendor të veçantë. P.sh. Nuk mund të ketë në rrugën Qemal Stafa dy ndërtesa me të njëjtin numër. Duhet shmangur dublikimet e numrave.

P.sh : 92 / 94 / 96 ...100 / 102..... Rruga: "Qemal Stafa"

Për bulevardet ose rrugët kryesore, që takohen në **qendrën e qytetit**, si pikë e nisjes për numërtimet e ndërtesave merret pikërisht qendra e qytetit.




P.sh. Në qendrën e kryeqytetit Tiranë takohen këto rrugë: Rruga e Kavajës / Rruga "Dibrës" / Rruga "Durrësit" / Blvd "Zogu i Parë".

¹ NJQV – Njësi e Qeverisjes Vendore.

Numërtimi rendor i ndërtesave do të fillojë me numrin më të vogël çift apo tek në varësi të krahut të rrugës, në pikënisje të secilës rrugë dhe do të vazhdojë numërimi i ndërtesave në progres gjatë gjithë gjatësisë së saj.


Numërtimi i ndërtesave që ndodhen përgjatë rrugëve kryesore, që nuk kryqëzohen në qendrën e qytetit, dhe në të gjitha rastet për të gjitha rrugët dytësore, numërtimi bëhet në mënyrë të tillë që numrat të vazhdojnë nga Lindja në Perëndim, nga Jugu në Veri, nga Verilindja në Jugperëndim dhe nga Juglindja në Veriperëndim, por jo edhe në drejtim të kundërt; (shih shembullin më poshtë).



Në qytetet ose fshatrat, që përshkohen nga një lumë ose që ndodhen në breg të detit ose liqenit, si pikënisje mund të merret pika e kontaktit ose pjesa më e afërt e rrugës me detin, liqenin apo lumin.


P.sh: Në rastin e qytetit të Durrësit që ndodhet në buzë të detit Adriatik të fillojë numërtimi i ndërtesave duke pasur parasysh që si pikënisje të jetë rruga kryesore më e afërt me detin.

Duke u nisur nga pika e nisjes së rrugës, bulevardit, rrugicës, sheshit ose parkut, ndërtesave, në krahun e majtë të drejtimit të tyre, u vihen numra tek 1, 3, 5, 7, 9 ...135...1007.., ndërsa atyre në krahun e djathtë numra çift 2, 4, 6, 8 ...36.....1040.....e kështu me radhë;



Ndërtesave, që ndodhen në rrugica me një dalje dhe që vlerësohen si vazhdim i një rrugës kryesore, u vihen numra rëndorë që i përkasin krahut të majtë ose të djathtë të kësaj rruge, nga e cila fillon rrugica pa dalje.

Kur rrugica pa dalje ka emrin e saj, ndërtesat që ndodhen në të dyja anët e rrugicës marrin numër specifik rëndor të veçantë. Ndërtesat që ndodhen në rrugica me një dalje dhe që konsiderohen si vazhdim i rrugës së daljes, i vihen numra rëndor sipas pozicionit në të majtë ose të djathtë të rrugës së daljes.



3.1.4.2. ADRESA

-- Përkufizim --

"Adresa" përbëhet nga fjalë, numra dhe shenja ortografike, të renditura sipas një rregulli të caktuar, të cilat tregojnë vendndodhjen e saktë dhe unike të një ndërtese, apartamenti ose të një trualli të lirë. Ajo formohet nga shkronja të alfabetit shqip, latin dhe numra arabë.

-- Përshkrim --

SHËNIM 1- Objekti gjeohapësinor, i referuar një adrese, është përcaktuar si "objekt i adresueshëm". Ky "objekt i adresueshëm" nuk është në skemën e aplikimit, por është e mundur që të përfaqësojë referimin e adresës për një parcelë kadastrale apo një ndërtesë. Megjithatë, ai duhet të theksohet se në vende dhe rajone të ndryshme, rregulloret përcaktojnë llojet e objekteve që duhet të konsiderohen si objekte të adresueshme.

SHËNIM 2- Në shumicën e situatave objektet e adresueshme janë aktuale, objekte reale. Megjithatë, adresat mund tu referohen objekteve, të cilat janë të planifikuara, në ndërtim e sipër apo edhe historike.

SHËNIM 3- Përveç identifikimit të objekteve të adresueshme (si p.sh. ndërtesa), adresat janë përdorur shumë shpesh nga një numër i madh i kërkesave të tjera për të identifikuar tipet e objekteve p.sh. statistikave e qytetarëve që jetojnë në ndërtesë, për tatimin e subjekteve të biznesit që ndodhet në këtë ndërtesë, si dhe instalimet e shërbimeve

SHËNIM 4- Për qëllime të ndryshme, identifikimi i një adrese mund të përfaqësohet në mënyra të ndryshme (shih shembullin 3).

SEMBULL 1- Një pronë mund (për shembull) të jetë një parcelë, tokë, ndërtesë, pjesë ndërtese, apo ndërtime të tjera.

SEMBULLI 2- Në Holandë objektet kryesore të adresueshme janë ndërtesat dhe banesat të cilat mund të përfshijnë pjesë të ndërtesave, vende ankorimi apo vende për vendosjen e përhershme të shtëpive të lëvizshme. Në Britani të Madhe ka një nivel më të ulët të njësisë për ofrimin e shërbimeve ndërsa në Republikën Çeke objektet kryesore të adresueshme janë ndërtesat dhe dyert e hyrjes.

SEMBULLI 3- Adresat mund të përfaqësohen ndryshe. Në një formë të lexueshme një adresë në Spanjë dhe një adresë në Danimarkë do të mund të përfaqësohet si ky: "Calle Mayor, 13, Cortijo del Marques, 41037 Ecija, Sevilla, España" apo "Wildersgade 60A, nr th, 1408 Copenhagen K., Danimarka".

Tipi i elementit – *Feature type*

KUFIZIMET
 OCL. VendodhjaEAdresës AddressPosition /* Një adresë duhet të ketë të përcaktuar saktë pozicionin gjeografik */ inv: self.position -> one(a1 a1.default = true)

KUFIZIMET

🔒 OCL: EVlefshmeDeri

/* Nëse vendoset vlera EVlefshmeDeri, ajo duhet të jetë më e vonë se EVlefshmeNga */
inv: self.validTo .isEqual(self.validFrom) or self.validTo .isAfter(self.validFrom)

🔒 OCL: PërfundimiICiklitJetësor

/* Nëse vendoset, vlera PërfundimiICiklitJetësor duhet të jetë më e vonë se FillimiICiklitJetësor */
inv: self.endLifespanVersion .isAfter(self.beginLifespanVersion)

LIDHJE NDIHMËSE

⇒ Agregim nga «featureType» KomponentëtEAdresave tek «featureType» Adresa

ATRIBUTET

📅 FillimiICiklitJetësor : Datë

-- Emri --

Fillimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --

Data në të cilën ky Versioni i objektit gjeohapësinor është krijuar ose ndryshuar në të dhënat gjeohapësinore.

[Detyrueshme : PO]

📍 IdentifikuesI Jashtëm : CharacterString

Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Përkufizim--

Identifikues tematike i jashtëm për adresën e objektit gjeohapësinor, i cili mundëson ndërveprimin me sistemet ekzistuese ose aplikacionet.

-- Përshkrim--

SHËNIM 1- Krahasuar me identifikuesit kryesor të adresës, identifikuesit alternativë nuk janë domosdoshmërisht të vazhdueshëm në jetëgjatësinë e adresave të objektit gjeohapësinor. Po ashtu, zakonisht kjo nuk është unike dhe në përgjithësi nuk përfshin informata mbi versionin e adresave të objektit gjeohapësinor.

SHËNIM 2- Shpesh identifikuesit alternativë të adresave janë të përbërë nga një grup kodesh që, për shembull, të identifikuarit e rajonit dhe komunës, emrin e rrugëkalimit dhe numrin e adresave. Këta identifikues alternativë nuk do të mbeten shembull i vazhdueshëm në rastin e bashkimit të dy njësive vendore.

[Detyrueshme : JO]

ATRIBUTET
 InspireId : Identifikues -- Përkufizim-- Identifikues i jashtëm i objektit gjeohapësinor. -- Përshkrim-- Një objekt identifikues i jashtëm është një identifikues unik i objektit të publikuar nga autoriteti përgjegjës, i cili të mund të përdoret nga aplikacionet e jashtme të referimit të objektit gjeohapësinor. Identifikuesi është një identifikues i objektit gjeohapësinor, jo një identifikues i fenomenit në botë. SHËNIM 2 Qëllimi kryesor i këtij identifikuesi është për të mundësuar lidhjet midis burimeve të ndryshme dhe komponentëve të adresave. [Detyrueshme : PO]
 IVlefshëmDeri : Date-Orë Shumëllojshmëria: [0..1] -- Përkufizim -- Data dhe koha në të cilën ky version i adresës përfundon/ose do të përfundojë së përdoruri ligjërisht. -- Shënim -- Kjo është data dhe ora e referencës së adresës e cila nuk mund të përdoret më në veprimet ligjore. [Detyrueshme : JO]
 IVlefshëmNga : Date-Orë -- Përkufizim -- Data dhe koha që ky version i adresës është ose do të jetë i vlefshëm ligjërisht. -- Shënim -- Kjo është data dhe koha kur mund të përdoret adresa kombëtare në veprimet ligjore. -- Përshkrim -- SHËNIM kjo datë dhe kohë mund të vendosen në të ardhmen për situatat ku një adresë apo një version i një adresë është vendosur nga autoriteti i duhur për të marrë fuqi për një datë të ardhshme. [Detyrueshme : PO]
 Lokalizues : IdentifikuesiAdresës Shumëllojshmëria: [1..*] -- Përkufizim-- Një lokalizues në formën e një numri rendor apo emërtimi, që i mundëson një përdoruesi dallimin nga adresa fqinje. Psh -- Shënim -- Një lokalizues mund të jetë numri i shtëpisë, numri i katit etj. [Detyrueshme : PO]
 PërfundimiICiklitJetësor : Datë Shumëllojshmëria: [0..1]

ATRIBUTET	
-- Emri -- Përfundimi i ciklit jetësor -- Përkufizimi -- Data në të cilën ky Versioni i objektit gjeohapësinor është përfunduar. [Detyrueshme : JO]	
 Pozicionimi : PozicionimiGjeografik Shumëllojshmëria: [1..*]	-- Përkufizim -- Pozicioni i një pikë karakteristike i cili përfaqëson vendndodhjen e adresës sipas një specifikimi të caktuar, duke përfshirë informacione mbi origjinën e pozicionit. [Detyrueshme : PO]
 Statusi : VleraEStatusit Shumëllojshmëria: [0..1]	-- Përkufizim -- Vlefshmëria e adresës brenda ciklit jetësor (Version) të adresës së objektit gjeohapësinor. -- Përshkrim -- SHËNIM: Ky status në lidhje me adresën nuk është karakteristikë e objektit për të cilën është caktuar adresa (objekti i adresueshëm). [Detyrueshme : JO]
LIDHJET	
 Lidhjet (drejtimi: Origjina -> Objektivi)	
Origjina: (Class) Adresa «featureType»	Objektivi: «voidable» AdresaMëmë (Class) Adresa «featureType» Shumëllojshmëria: [0..1] -- Përkufizim -- Adresa kryesore (prind) me të cilën është e lidhur fort kjo (nën) adresë. -- Përshkrim -- SHËNIM 1 Marrëdhënia ndërmjet një sërë nën-adresash dhe adresës kryesore shpesh do të thotë se nën adresat përdorin të njëjtin lokalizues dhe komponent të adresës (për shembull, emri i adresës së zonës, kodi postar) si adresa mëmë. Për secilën nën-adresë janë përfshirë lokalizues shtesë të adresës për identifikimin e saj, si p.sh. numri i katit, identifikuesi i kati, numri i hyrjes.

LIDHJET

SHËNIM 2 Në disa vende ekzistojnë disa nivele dhe nën-nivele të adresës mëmë. Në vende të tjera, koncepti i adresave mëmë nuk ekziston; të gjitha adresat janë kështu të të njëjtit nivel.

SHEMBULLI 1 Në një qytet spanjoll adresa "Calle Gran Via 8" është një adresë prind ku lokalizuesi "8" përfaqëson ndërtesën. Në ndërtesë, nën adresa "Calle Gran Via 8, dera 3", përfaqëson një nën-adresë, ndërsa nën adresa më e hollësishme "Calle Gran Via 8, dera 3, shkallë A, kati 5, banesa 1" përfaqëson adresa e një banesë të veçantë.

SHEMBULLI 2 Në Danimarkë legjislacioni i adresave përcaktojnë dy lloje të adresash: prind "të nivelit të qasjes" dhe nën "nivelit njësi". Në qytetin e Kopenhagës "Wildersgade 60A" është një adresë kryesore prind që përfaqëson një hyrje të veçantë në një ndërtesë. Brenda hyrjes, nën adresa ka përdorur dyshemenë dhe dyert si tregues që identifikon banesat individuale si p.sh. "Wildersgade 60A, kati 1, dera e majtë".

SHEMBULLI 3 Në Holandë ekziston vetëm një nivel i adresave.

✍ Lidhjet (drejtimi: Origjina -> Objektivi)

Origjina: (Class) Adresa «featureType»

Objektivi: «voidable» Ndërtesa (Class)
KonstruktionAbstrakt «featureType»
Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri--
Ndërtesa

-- Përkufizim --
Adresa është e caktuar ose e lidhur me ndërtesën.

-- Përshkrim --
SHËNIM Një adresë potencialisht mund të ketë një ose disa ndërtesa. Gjithashtu është e mundur (por kjo nuk është shprehur në këtë skemë aplikimi) që disa adresa janë të lidhura në një ndërtesë të vetme.

✍ Lidhjet (drejtimi: Origjina -> Objektivi)

Origjina: Public (Class) Adresa «featureType»

Objektivi: «voidable» Parcelë (Class)
ParcelatKadastrale «featureType»
Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Përkufizim --
Parcela kadastrale që kjo adresë është e lidhur.

-- Përshkrim --
Një adresë mund të ketë lidhje me zero, një ose shumë parcela kadastrale. Gjithashtu është e mundur

LIDHJET	
	që shumë adresa të lidhen me një parcelë kadastrale (kjo nuk është e paraqitur në keto skema aplikimi).
✍ Lidhjet (drejtimi: Origjina -> Objektivi) Origjina: Public (Class) Përfaqësimi Adresës «dataType»	Objektivi: «voidable» Tipari Adresës (Class) Adresa «featureType» Shumëllojshmëria: [0..1] -- Përkufizim -- Referenca për adresën e objektit gjeohapësinor.
✍ Lidhjet (drejtimi: Origjina -> Objektivi) Origjina: Public (Class) Adresa «featureType»	Objektivi: «voidable» AdresaMëmë (Class) Adresa «featureType» Shumëllojshmëria: [0..1] -- Përkufizim -- Adresa kryesore (prind) me të cilën është e lidhur fort kjo (nën) adresë. -- Përshkrim -- SHËNIM 1 Marrëdhënia ndërmjet një sërë nën adresash dhe adresës kryesore shpesh do të thotë se nën adresat përdorin të njëjtin lokalizues dhe komponent të adresës (për shembull, emri i adresës së zonës, kodi postar) si adresën mëmë. Për secilën nën adresë janë përfshirë lokalizues shtesë të adresës për identifikimin e saj, si p.sh. Numri i katit, identifikuesi i kati, numri i hyrjes. SHËNIM 2 Në disa vende ekzistojnë disa nivele të dhe nën-nivele të adresës mëmë. Në vende të tjera, koncepti i adresave mëmë nuk ekziston; të gjitha adresat janë kështu të të njëjtit nivel. SHEMBULLI 1 Në një qytet spanjoll adresa "Calle Gran Via 8" është një adresë prind ku lokalizuesi "8" përfaqëson ndërtesën. Në ndërtesë, nën adresa "Calle Gran Via 8, dera 3", përfaqëson një nën-adresë, ndërsa nën adresa më e hollësishme "Calle Gran Via 8, dera 3, shkallë A, kati 5, banesa 1" përfaqëson adresën e një banesë të veçantë. SHEMBULLI 2 Në Danimarkë legjislacioni i adresave përcakton dy lloje të adresave: prind "të nivelit të qasjes" dhe nën "nivelit njësi". Në qytetin e Kopenhagës "Wildersgade 60A" është një adresë kryesore prind që përfaqëson një hyrje të veçantë në një ndërtesë. Brenda hyrjes, nën adresa përdorur dyshemenë dhe dyert si tregues që identifikon banesat individuale si p.sh. "Wildersgade 60A, kati 1, dera e majtë". SHEMBULLI 3 Në Holandë ekziston vetëm një nivel i adresave.

3.1.4.3. EMRI ADRESËS SË BASHKISË

-- Përkufizim--

Një tregues, që përfaqëson emrin e një zonë gjeografike apo lokalitet me objekte të adresueshme për qëllime adresimi.

-- Përshkrim--

SHËNIM 1- Në disa vende dhe rajone adresa e zonës është një nënndarje e vertetë e një njësie administrative (p.sh. bashkia), në mënyrë që çdo adresë e zonës është plotësisht brenda komunës dhe në mënyrë që çdo pjesë e bashkisë është brenda zonës së adresave. Në vende të tjera, koncepti i emrave të adresës së zonës është më pak i rëndësishëm në bazë të nevojave të veçanta.

Tipi i elementit – *Feature type*

LIDHJE NDIHMESE			
↔ Gjeneralizim nga «featureType» EmriAdresësSëRrethit tek «featureType» KomponentëtEAdresave			
ATRIBUTET			
 Emri : EmërtimetGjeografike Shumëllojshmëria:[1..*]			
-- Përkufizim-- Emrat e aplikuar në zonën e adresave. [Detyrueshme : PO]			
LIDHJET			
 Lidhjet (drejtimi: Origjina -> Objektivi)			
Origjina: FillimiICiklitJetësor (Class)	EmriAdresësSëRrethit	Objektivi: «avoidable» EmërtimiIVendit (Class)	EmërtimiIVendit «featureType» Shumëllojshmëria: [0..1]
«featureType»			
-- Përkufizim --		-- Përkufizim -- Emri i vendit që përfaqëson adresën e zonës.	
		-- Përshkrim -- SHËNIM: me qëllim që të bëjë të njohur këtë lidhje është e rëndësishme që zona e mbuluar nga emri i vendit të identifikuar është saktësisht e njëjtë me zonën e mbuluar me emrin e adresës në fjalë.	
		SHEMBULL Emri gjeografik "Huskvarna", që përfaqëson një pjesë të komunës së Jönköping në Suedi, është burimi i adresës së emrit të zonës, "Huskvarna".	

3.1.4.4. EMRI I NJËSISË ADMINISTRATIVE

-- Përkufizim --

Një komponent i adresës që përfaqëson emrin e një njësie të administratës, ku një shtet anëtar ka dhe / ose ushtron të drejtat juridiksionale, për qeverisjen lokale, rajonale dhe kombëtare.

Tipi i elementit – *Feature type*

LIDHJE NDIHMESE	
← Gjeneralizim nga «featureType» EmriINjesisëAdministrative tek «featureType» KomponentëtEAdresave	
ATRIBUTET	
 Emërtimi : EmërtimetGjeografike Shumëllojshmëria: [1..*]	
-- Përkufizim-- Emri zyrtar kombëtar gjeografik i njësisë administrative, jepet në gjuhë të ndryshme duke pasur parasysh ku kërkohet.	
[Detyrueshme : PO]	
 Niveli : HierarkiaENjësiveAdministrative	
-- Përkufizim-- Niveli i administratës në hierarkinë administrative kombëtare.	
[Detyrueshme : PO]	
LIDHJET	
 Lidhjet (drejtimi: Origjina -> Objektivi)	
Origjina: (Class) EmriINjesisëAdministrative «featureType»	Objektivi: «voidable» NjësitëAdm (Class) NjësitëAdministrative «featureType» Shumëllojshmëria: [1]
-- Përkufizim -- Njësia administrative që është burimi i përmbajtjes së emrit të njësisë administrative.	
-- Përshkrim -- SHEMBULL Njësia administrative (bashkia) "Gävle" në Suedi është burimi i komponentit të adresës së emrit të njësisë administrative, "Gävle".	

3.1.4.5. EMRI I LOKALIZUESIT

-- Përkufizim--

Emër i përveçëm i aplikuar për një element reale të identifikuar nga lokalizuesi.

-- Përshkrim--

SHËNIM Emri i lokalizuesit mund të jetë emri i pronës, i ndërtesës apo i pjesës së ndërtesës, ose ai mund të jetë emri i një dhomë brenda një ndërtese.

Tipi i elementit – Data type

ATRIBUTET
 Emri : EmërtimetGjeografike Shumëllojshmëria: ([1..*]) -- Përkufizim-- Pjesa e identifikimit të emrit të lokalizuesit -- Përshkrim-- SHËNIM 1 Lloji i të dhënave lejon emra në gjuhë dhe skripte të ndryshme, si dhe përfshirjen e emrit alternativ, shpjegues alternative, emrin historik. SHËNIM 2 Emri i lokalizuesit mund të jetë emri i pronës, i ndërtesës apo pjesës së ndërtesës (p.sh. krahut), ose ai mund të jetë emri i një dhome ose të ngjashëm brenda ndërtesës. SHËNIM 3 Ashtu si emri i lokalizuesit është gjithashtu e mundur që të përdorin një tekst përshkruar që lejon një përdorues të identifikojë pronën në fjalë. [Detyrueshme : PO]
 Lloji : VleraELlojitTëEmritTëLokalizuesit -- Përkufizim-- Lloji i vlerës së lokalizuesit, e cila mundëson një kërkesë për të interpretuar, një analizë gramatikore sipas rregullave të caktuara. -- Përshkrim-- SHËNIM Lloji i mundëson një përdoruesi ose një kërkesë për të kuptuar nëse emri "Sheshi Shqiponja" është për shembull emër i një vendi të veçantë apo e një ndërtese. [Detyrueshme : PO]

3.1.4.6. EMRI I RRUGËKALIMIT

-- Përkufizim --

Një element i adresës që përfaqëson emrin e një kalimi ose rrugëkalimi nga një vend në tjetrin.

-- Përshkrim --

SHËNIM 1 Një rrugëkalim mund të jetë rrugë ose kalim ujq

SHËNIM 2 Emri i rrugëkalimit përfshin emrat e shesheve dhe të rrugëve, ato gjithashtu mund të përfaqësojnë rrjetin e rrugëve të vogla apo shtigjeve p.sh. një fshat të vogël ose vendbanim.

Tipi i elementit – Feature type

LIDHJE NDIHMESE	
↔ Gjeneralizim nga «featureType» EmriRrugëkalimit tek «featureType» KomponentëtEAdresave	
ATRIBUTET	
 Emri : EmërtimetGjeografike Shumëllojshmëri: [1..*] --Përkufizim-- Emri i përveçëm i aplikuar për rrugëkalimin. -- Përshkrim -- SHËNIM1 Më shpesh rrugëkalimet janë rrugë, në këtë situatë emri rrugëkalimit është emri i rrugës. [Detyrueshme : PO]	
LIDHJET	
 Lidhjet (drejtimi: Origjina -> Objektivi) Origjina: (Class) EmriRrugëkalimit «featureType» Objektivi: «voidable» transportLink (Class) TransportLink «featureType» Shumëllojshmëria: [0..*] -- Përkufizim -- Një ose disa lidhje të rrjetit të transportit në të cilën emri rrugëkalimit të objektit gjeohapësinor ka qenë i caktuar. -- Përshkrim -- SHEMBULL Emri rrugëkalimit "Na Pankráci" në Praha, Republika Çeke, ka qenë i caktuar si një emër rrugë për një numër të lidhjeve rrugore (segmente të rrugës) në qytet.	

3.1.4.7. EMËRTIMI I LOKALIZUESIT

-- Përkufizim--

Një numër apo një sekuençë e karaktereve, që në mënyrë unike identifikon lokalizuesin brenda fushës përkatëse. Identifikimi i plotë i lokalizuesit mund të përfshijë një ose më shumë tregues të lokalizuesit

-- Përshkrim--

SHËNIM 1- Emërtimi i lokalizuesit është caktuar shpesh në bazë të një sërë rregullash zakonisht të njohura, i cili mundëson një përdorues apo kërkesë për "analizimin" e informacionit: Numrat e adresës caktohen më shpesh në ngjijtje, në një ndërtesë, identifikuesi i katit përfaqëson nivelin bazë të emërimit brenda zonës, p.sh, 1, 2, 3.

SHËNIM 2- Ekzistojnë disa lloje emërtimi të lokalizuesit, të tilla si: numri adresës, identifikuesit e ndërtimit, emri i ndërtimit.

Tipi i elementit –Data type

ATRIBUTET
🔹 Emërtimi : Karakter Varg --Përkufizim -- Pjesa e identifikimit të emërimit të lokalizuesit përbëhet nga një ose më shumë shifra ose karaktere të tjera. --Përshkrim -- SHËNIM Vlera është shpesh një kod përshkruar i caktuar në bazë të rregullave të njohur të caktuar p.sh. në rendin rritës të numrave: 0, 1, 2, 3. [Detyrueshme : PO]
🔹 Lloji : VleraELlojitTëEmërimitTëLokalizuesit --Përkufizim -- Lloji i vlerës së lokalizuesit, e cila mundëson një kërkesë për tu interpretuar, sipas analizës gramatikore apo rregullave të caktuara. --Përshkrim -- SHËNIM Lloji i mundëson një përdoruesi ose një kërkesë për të kuptuar nëse vlera e "A" është p.sh. një identifikues i një ndërtesë të veçantë, dere, shkallë apo banesë. [Detyrueshme : JO]

3.1.4.8. IDENTIFIKUESI I ADRESËS

-- Përkufizim --

Një emërtim i lexueshëm për njerëzit apo emër që lejon një përdorues apo kërkesë për të dalluar adresën nga adresat fqinje, në kuadër të një emri, emri të rrethit, emri të njësisë administrative ose themeluesit postar, në të cilën ndodhet adresa.

-- Përshkrim --

SHËNIM 1- Lokalizuesit më të zakonshëm janë emërtuar të tilla si një numër i adresës, numër identifikues ndërtese, ose banesë, si dhe emrin e pronës.

SHËNIM 2- Identifikuesit lokalizues janë më të qartë dhe kuptimplotë në kuadër të emrit të rrethit ngjitur ose kodit postar.

SHËNIM 3- Lokalizuesi mund të përbëhet nga një ose më shumë tregues p.sh, numri adresës, numri ndërtesë ose emri, numri katit, identifikuesi banesës ose dhomës.

SHËNIM 4- Lokalizimi i një adrese mund të përbëhet si një hierarki, ku një nivel i lokalizuesit identifikon pronën e paluajtshme ose ndërtesën, ndërsa një tjetër nivel i lokalizuesit identifikon banesën apo vendbanimet brenda pronës.

Tipi i elementit – Data type

KUFIZIME
🔗 OCL. EmertimiBosh /*Nëse nuk ekziston emërtimi, emri është i nevojshëm */ inv: self.designator->isEmpty() implies self.name->notEmpty()
🔗 OCL. EmriBosh /*Nëse nuk ekziston emri, emërtimi është i nevojshëm */ inv: self.designator->isEmpty() implies self.name->notEmpty()
ATRIBUTET
📍 Emertimi : EmertimiLokalizuesit Shumëllojshmëri: [0..*] -- Përkufizim -- Një numër apo një sekuencë e karaktereve që në mënyrë unike identifikon lokalizuesin brenda fushës përkatëse. [Detyrueshme : PO]
📍 Emri : EmriLokalizuesit Shumëllojshmëri: [0..*] -- Përkufizim -- Një emër gjeografik ose tekst përshkruar i lidhur për një karakteristikë të identifikuar nga lokalizuesi -- Përshkrim -- SHËNIM 1 Emri lokalizuesit mund të jetë emri i pronës ose i përbërë (p.sh. një pasuri, spital apo qendër tregtare), një ndërtesë apo pjesë ndërtese (p.sh. krahut), ose ajo mund të jetë emri i një dhome brenda ndërtesës. SHËNIM 2 Ashtu si emri lokalizuesit është gjithashtu e mundur që të përdorin një përshkrim që lejon një përdorues të identifikojë pronën në fjalë.

ATRIBUTET	
Shembull në adresën "Calle Santiago, 15, Elizondo-Baztán, Navarra, Spain" emri ndërtimit "Urtekoetxea" është një identifikues alternativ për ndërtimin "3".	[Detyrueshme : JO]
 Niveli : VleraENivelitTëLokalizuesit -- Përkufizim -- Niveli në të cilin referohet lokalizuesi	[Detyrueshme : JO]

LIDHJET	
 Lidhjet (drejtimi: Origjina -> Objektivi) Origjina: Public (Class) IdentifikuesiAdresës «dataType» withinScopeOf	Objektivi: «voidable» BrendaFushësSë (Class) KomponentëtEAdresave «featureType» Shumëllojshmëria: [0..1] -- Përkufizim -- Komponenti i adresës që përcakton fushën brenda të cilit lokalizuesi i adresës është përcaktuar sipas rregullave të qarta. -- Përshkrim-- SHËNIM 1 Për caktimin e saktë të lokalizuesit (p.sh. numrat e adresës) ekzistojnë rregulla të ndryshme në vende dhe rajone të ndryshme. Sipas rregullit më të zakonshëm, një numër adrese duhet të jetë unik brenda fushës së emrit të rrugëkalimit. Në fusha të tjera, numri adresës është unik brenda zonës së adresës (p.sh. emri i fshatit) ose themeluesit postar (p.sh. kodin postar). Në disa zona një kombinim i rregullave që aplikohen: p.sh. adresat me dy lokalizues, secili prej tyre referohet në një përbërës të veçantë të adresave. SHEMBULLI 1 Në një dataset tipik evropian të adresave, pjesa e adresave kanë lokalizues të cilat janë të qarta në kuadër të emrit rrugor (emri rrugëkalimit), ndërsa të tjerët janë të qarta brenda emrit të fshatit apo qarkut.

3.1.4.9. KOMPONENTËT E ADRESAVE

-- Përkufizim --

Identifikues ose emri specifik gjeografik i vendndodhjes së një zone, apo objekti tjetër specifik gjeohapësinor që përcakton fushëveprimin e një adrese.

-- Përshkrim --

SHËNIM 1- Katër nënklasa të ndryshme të komponentëve të adresave janë të përcaktuara:

- Emri i njësive administrative, të cilat mund të përfshijnë emrin e bashkisë, emrin e komunës, emrin e rrethit

-Emri adresës së zonë si p.sh. Emri i fshatit apo vendbanimit.

-Emri rrugëkalim, më shpesh emri rrugor

-Përshkrimi Postar

Në mënyrë që të ndërtojmë një adresë, këto nën-klasa janë të strukturuar shpesh në mënyrë hierarkike.

SHEMBULL- Kombinimi i lokalizuesit "13" dhe komponentët e adresës "Calle Mayor" (emri rrugëkalimit), "Cortijo del Marques" (emri i zonës së adresës), "41037" (përshkruesi postar), "Écija", "Sevilla" dhe "España" (emrat e njësive administrative) e bën këtë adresë të veçantë me attribute të qarta dhe të lexueshme.

Tipi i elementit – Feature type

KUFIZIME
 OCL. PërfundimiICiklitJetësor /* Nëse vendoset, vlera PërfundimiICiklitJetësor duhet të jetë më e vonë se FillimiICiklitJetësor */ inv: self.endLifespanVersion.isAfter(self.beginLifespanVersion)
LIDHJE NDIHMESE
 Agregim nga «featureType» KomponentëtEAdresave tek «featureType» Adresa
LIDHJE NDIHMESE
 Gjeneralizim nga «featureType» EmriRrugëkalimit tek «featureType» KomponentëtEAdresave
 Gjeneralizim nga «featureType» EmriAdresësSëRrethit tek «featureType» KomponentëtEAdresave
 Gjeneralizim nga «featureType» EmriINjësiseAdministrative tek «featureType» KomponentëtEAdresave
 Gjeneralizim nga «featureType» PërshkruesiPostare tek «featureType» KomponentëtEAdresave

ATRIBUTET

IVlefshëmDeri : Date-Orë
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Përkufizim --

Data dhe koha në të cilën ky version i adresës përfundon/ose do të përfundojë së përdoruri ligjërisht.

-- Shënim --

Kjo është data dhe ora e referencës së adresës e cila nuk mund të përdoret më në veprimet ligjore.

[Detyrueshme : JO]

IVlefshëmNga : Date-Orë

-- Përkufizim --

Data dhe koha që ky version i adresës është ose do të jetë i vlefshëm ligjërisht.

-- Shënim --

Kjo është data dhe koha kur mund të përdoret adresa kombëtare në veprimet ligjore.

-- Përshkrim --

SHËNIM - Kjo datë dhe kohë mund të vendoset në të ardhmen për situatat ku një adresë apo një version i një adresë është vendosur nga autoriteti i duhur për të marrë fuqi për një datë të ardhshme.

[Detyrueshme : PO]

Fillimi i CiklitJetësor : Datë

-- Emri --

Fillimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --

Data në të cilën ky Versioni i objektit gjeohapësinor është krijuar ose ndryshuar në të dhënat gjeohapësinore.

[Detyrueshme : PO]

IdentifikuesAlternativ : CharacterString
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Përkufizim--

Identifikues tematik i jashtëm për adresën e objektit gjeohapësinor, i cili mundëson ndërveprimin me trashëgiminë e sistemeve ekzistuese ose aplikacionet.

-- Përshkrim--

SHËNIM-1 Krahësuar me identifikuesin kryesor të adresës, identifikuesi alternativ nuk është domosdoshmërisht i vazhdueshëm në ciklin jetës të adresave të objektit gjeohapësinor. Po ashtu kjo zakonisht nuk është unike dhe në përgjithësi nuk përfshin informata mbi versionin e adresave të objektit gjeohapësinor.

SHËNIM 2- Shpesh identifikuesit alternativë të adresave janë të përbërë nga një grup i kodeve, për shembull, identifikuesit e rajonit dhe komunës, emrin e rrugëkalimit dhe numrin e adresave. Këta identifikues alternativë nuk do të mbetet të njëjtë në rastin e bashkimit të dy komunave.

ATRIBUTET	
[Detyrueshme : JO]	
 InspireId : Identifikues Shumëllojshmëria: [0..1] -- Përkufizim-- Identifikues i jashtëm i objektit gjeohapësinor. -- Përshkrim-- SHENIMI Një objekt identifikues i jashtëm është një identifikues unik i objektit të publikuar nga autoriteti përgjegjës, i cili mund të përdoret nga aplikacionet e jashtme të referimit të objektit gjeohapësinor. Identifikuesi është një identifikues i objektit gjeohapësinor. SHENIM 2 Qëllimi kryesor i këtij identifikuesi është për të mundësuar lidhjet midis burimeve të ndryshme dhe komponentëve të adresave. SHEMBULL Komponentet e një adrese të një objekti gjeohapësinor nga Danimarka mund të kryejnë këto identifikues: Hapësira: DK_ADR Identifikues lokale: 0A3F507B2AB032B8E0440003BA298018 Versioni identifikues: 12-02-2008T10: 05: 01 + 01: 00	
[Detyrueshme : PO]	
